



AMAP



PROGRAMI SHQIPTAR PËR VEPRIMIN NDAJ MINAVE



Kryetari i AMAC në Seminarin Rajonal të Tiranës për një Europë Juglindore pa Mina, Tetor 2009



Delegacioni Shqiptar në Seminarin Rajonal të Tiranës për një Europë Juglindore pa Mina, Tetor 2009



Vizita e përfaqësuesve të Departamentit Amerikan të Shtetit në zyrën e AMAE-së

Të Përgjithshme

Ndotja me mina dhe municione të paplasura në veri-lindje të Shqipërisë ishte pasojë e konfliktit në Kosovë në vitin 1999 dhe përfshiu 120 km vijë kufitare midis Shqipërisë dhe Kosovës. Ajo shtrihej deri në kufirin me Malin e Zi në veri si dhe shkonte deri në 20 km brenda territorit shqiptar. Nga survejimi i bërë nga Forcat e Armatosura Shqiptare (FASH) në vitin 1999 u identifikuan rreth 15,250,000 m² tokë si zona të ndotura me mina dhe municione të paplasura duke përfshirë edhe municionet thërrmuese. Rreziku përfshinte mina kundër personit dhe mina anti-tank si dhe municione të paplasura (UXO) duke prekur direkt



39 fshatra në veri-lindje të Shqipërisë, në rrethet Kukës, Has dhe Tropojë. Një problem që e komplikonte më tej situatën ishte fakti se Shqipëria nuk disponon harta të këtyre fushave të minuara.

Qeveria Shqiptare ratifikoi Konventën mbi Ndalimin e Përdorimit, Magazinimit, Prodhimit dhe Transferimit të Minave kundër Personit dhe Shkatërrimit të tyre në 29 shkurt 2000. Në këtë mënyrë, Shqipëria, ndërmori mes te tjerash dhe detyrimet për shkatërrimin e të gjitha stoqeve të minave kundër personit brenda vitit 2004 si dhe pastrimin e të gjitha zonave të prekura nga minat në territorin e saj brenda vitit 2010.

Strukturat kombëtare të Veprimit ndaj Minave të ngritura që në vitin 1999, konsistojnë në Komitetin Shqiptar të Veprimit ndaj Minave, strukturë ndër-ministore për hartimin e politikave

(AMAC) dhe në Qendren Shqiptare të Veprimit ndaj Minave (AMAE), e cila është përgjegjëse për zbatimin e Programit të Veprimit ndaj Minave.

Një strategji kombëtare, që përfshin komponentët kryesorë të veprimit ndaj minave sic janë: çminimi, edukimi i popullsisë mbi rrezikun e minave dhe asistencë ndaj të aksidentuarve, është hartuar që në vitin 2002 duke përcaktuar vizionin, misionin dhe objektivat strategjike të Programit të Veprimit ndaj Minave.

Misioni i Programit Shqiptar të Veprimit ndaj Minave që të deklarohet Shqipërinë të pastër nga minat, brenda vitit 2010, në përputhje me detyrimet e Konventës së Ndalimit të Minave Kundër Personit, u përmbush me sukses në Tetor 2009.



Delegacioni i KE në Shqipëri

Ky raport u publikua me asistencën e Bashkimit Europian dhe PNUD. Pikëpamjet e shprehura në këtë raport në asnjë rast nuk reflektojnë opinionin e Bashkimit Europian ose Kombeve të Bashkuara, duke përfshirë PNUD ose shtetet e tyre anëtare.



UNDP
Albania

Pasoja e ndotjes me mina dhe municione të paplasura



I aksidentuar nga minat me familjen e tij.

Ndotja me mina/municione të paplasura preku Prefekturën e Kukësit në veri-lindje të Shqipërisë, që është një nga zonat më të varfëra në vend. Aktivitetet kryesore të banorëve janë bujqësia, blegtoria, mbledhja e drurëve të zjarrit e aktivitete të tjera për mbijetesë. 39 fshatra në verilindje të Shqipërisë me një popullsi rreth 25,000 u prekën fillimisht nga ndotja me mina. Problemi i minave ka patur një ndikim negativ në zhvillimin e infrastrukturës dhe tek mjedisi duke u bërë një pengesë serioze për zhvillimin e eko-turizmit në këtë rajon.


Pasojë tjetër serioze e ndotjes me mina të zonës kufitare ka të bëjë me vështirësitë që krijoi në patrullimin e rregullt të kufirit si dhe parandalimin e trafiqeve dhe të kundravajtjeve të tjera. Që nga fundi i konfliktit në Kosovë, 13 policë u plagosën nga minat dhe municionet e paplasura në përpjekje për të kryer detyrën e tyre. Elëminimi i këtij rreziku përmirësoi menaxhimin e integruar në kufirin verilindor të Shqipërisë.

Megjithëse shumica e njerëzve në verilindje të Shqipërisë u informuan dhe u edukuan mbi rrezikun e minave, përsëri banorët u përballën me rrezikun për arsye të nevojës ekonomike që i detyronte të përdornin zonat e minuara. Që nga viti 1999, kanë ndodhur 210 aksidente me mina, 34 persona janë vrarë dhe 238 u plagosën; afërsisht një e treta ishin në moshë aktive për punë nga 15-45 vjeç në momentin e aksidentit ndër-



Aktivitetet për Edukimin mbi Rrezikun ndaj Minave

sa gjysma e tyre janë aksidentuar gjatë punëve të përditshme të tyre në bujqësi, blegtori ose duke shkuar në shkollë. Si rezultat i edukimit të popullsisë mbi rrezikun e minave si dhe operacioneve të çminimit, incidenti i fundit me mina ose municione të paplasura në Prefekturën e Kukësit është regjistruar në qershor të vitit 2005.



Reagimi i Qeverisë Shqiptare

Qeveria Shqiptare në vitin 1999, ngriti strukturat për zbatimin e Programit Shqiptar të Veprimit ndaj Minave (AMAP). Politikat dhe strategjitë u formuluan nga Komiteti Shqiptar i Veprimit ndaj Minave (AMAC) dhe u zbatuan nga Qendra Shqiptare e Veprimit ndaj Minave (AMAE). Gjithashtu Qeveria Shqiptare që nga viti 1999 deri në vitin 2009 ka kontribuar në natyrë dhe me materiale të tjera në mbështetje të programit me një vlerë totale prej 2,700,000 USD. Qysh prej vitit 2005 Qeveria Shqiptare nëpërmjet Ministrisë së Mbrojtjes ka mbështetur në veçanti operacionet e çminimit duke dhënë fjalas materiale eksplozive dhe duke siguruar shër-



Mbështetje me helikopter nga Min. e Mbrojtjes

bimin me helikopter për evakuime mjeksore në rast aksidenti gjatë operacioneve të çminimit.

Mbështetja Ndërkombëtare për AMAP

Aktivitetet e Programit Shqiptar të Veprimit ndaj Minave janë mbështetur nga donatorët ndërkombëtarë siç janë Qeveritë e Austrisë, Kanadasë, Republikës Çeke, Danimarkës, Francës, Gjermanisë, Luksemburgut, Norvegjisë, Sllovenisë, Suedisë, Mbretërisë së Bashkuar (DfID), Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Komisionit Europian, Komiteti i Kryqit të Kuq Ndërkombëtar (ICRC), Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (PNUD) dhe UNICEF.

Në veçanti, PNUD dhe Fondi Ndërkombëtar i Besimit në Slloveni (ITF) kanë luajtur rol kryesor në ndërtimin e kapaciteteve të AMAE-s dhe të Kapacitetit Kombëtar të Çminimit nëpërmjet asistencës teknike dhe trajnimeve. Gjithashtu AMAE është mbështetur në ndërtimin e kapaciteteve edhe nga Qendra Ndërkombëtare e Çminimeve Humanitare në Gjenevë (GICHD), UNMAS dhe Shtabi i Përgjithshëm Zvicerian. Partnerë të tjerë zbatues të Programit të Veprimit ndaj Minave gjatë gjithë këtyre viteve përfshijnë: autoritetet lokale në Qarkun e Kukësit,



Eksperti zvicerian gjatë një vizite në terren, Kukës

autoritetet e shërbimit kombëtar mjekësor, DanChurchAid, Fondacionin Zvicerian për Çminim, RONCO, HELP, ALB-AID (ish Shoqata e Viktimave të Minave – Kukës) ICRC, FSD, Handicap International dhe Kryqi i Kuq Shqiptar.

Projekti i Azgjesimit të Stoqeve të Minave kundër Personit

Si pjesë e detyrimeve që rrjedhin nga Konventa mbi ndalimin e minave kundër personit, Shqipëria ndërmori shkatërrimin e stoqeve të minave kundër personit. Projekti u zbatua nga NAMSIA dhe u financua kryesisht nga Kanadaja dhe Shqipëria me donacione shtesë nga Austria, Belgjika, Hungaria, Norvegjia, Holanda, Zvicra dhe Anglia. Kontributi i Qeverisë Shqiptare në këtë projekt ishte venia në dispozicion të Uzines së Lëndëve Plasëse në Mjekës për çmilitarizimin e minave si dhe transportimin e tyre nga pothuajse 57 depo ushtarake në të gjithë Shqipërinë. Në 4 prill 2002, Shqipëria azgjesoi minën e fundit nga një total prej 1,683,860 mina kundër personit, dy vite përpara afatit të përcaktuar nga traktati.

Planifikimi, Monitorimi dhe Koordinimi

Strategjia Kombëtare e Veprimit ndaj Minave, e krijuar në vitin 2002 dhe e rishikuar në mënyrë periodike ka përcaktuar vizionin, misionin, prioritetet dhe një Plan Kombëtar për Veprimin ndaj Minave. Kuadri i rishikuar i këtij Plani është:

- **Vizioni** – Shqipëria e pastër nga minat dhe municionet e paplasura brenda vitit 2010.
- **Misioni** – Zbatimi i një programi të qëndrueshëm të Veprimit ndaj Minave deri në eliminimin e plotë të rrezikut nga mi-



Operacione të kontrollit të cilësisë të AMAE-së

nat dhe municionet e paplasura në Shqipëri. Përgjegjësitë e AMAE-s përfshijnë koordinimin dhe monitorimin e të gjitha aktiviteteve të Veprimit ndaj Minave në vend. Në këtë mënyrë AMAE cakton prioritetet, zhvillon dhe koordinon të gjitha operacionet bazuar në Planin Kombëtar të Veprimit ndaj Minave. Agjencitë zbatuese të Programit të Veprimit ndaj Minave akreditohen nga



Udhëtim me donatorët në zonat e prekura nga minat në Qarkun e Kukësit

AMAE në bazë të procedurave standarte të sigurisë dhe pas një vlerësimi për zbatimin në praktikë të këtyre procedurave. Ndërkohë, AMAE përcakton detyrat, mbledh informacionin, ruan dhe



Seminar i planifikimit të Veprimit Kombëtar ndaj Minave shpërndan raportet operacionale, verifikon operacionet e kryera dhe lëshon certifikatat e dorëzimit të tokave të pastruara nga minat. AMAE me mbështetjen e Qendrës Ndërkombëtare për Çminime Humanitare në Gjeneve (GICHD) ka krijuar që në 2003 Sistemin Informatik të Manaxhimit të Veprimit (IMSMA) ndaj Minave nëpërmjet të cilit mund të prodhohet informacion mbi rrezikun e mbetur dhe progresin e operacioneve të çmin-



imit si dhe të informojë partnerët zbatues mbi incidentet/aksidentet e shkaktuara nga minat.

Kapacitetet e nevojitura për monitorimin e operacioneve të çminimit janë ngritur me mbështetjen e donatorëve ndërkombëtarë, të cilat përfshijnë monitorimin e Sigurimit të Cilësisë dhe Kontrollit të Cilësisë. Monitorimi i Sigurimit të Cilësisë gjatë operacioneve verifikon nëse praktikatat e menaxhimit dhe procedurat operacionale të çminimit janë të përshtatshme dhe plotësojnë standartet ndërkombëtare në drejtim të sigurisë, efikasitetit dhe efikasitetit, ndërsa Kontrolli i Cilësisë së një zone të pastruar synon të garantojë që produkti është në përputhje me standartet. Zyra Rajonale e AMAE-s e ngritur në Kukës ka monitoruar dhe koordinuar drejtpërdrejtë aktivitetet e veprimit ndaj minave në terren. Operacionet e AMAE-s financohen aktualisht nga Komisioni Europian, nëpërmjet PNUD-it Shqipëri.

Operacionet e Çminimit dhe Dorëzimi i Tokës së Pastruar tek Komuniteti

Operacionet e çminimit në Shqipëri kanë filluar që në vitin 1999 dhe janë kryer nga organizata ndërkombëtare çminuese të ndryshme, siç janë HELP Gjermani, RONCO, Swiss Foundation for Demining (FSD) dhe DanChurchAid (DCA). Mjetet e çminimit të përdorura nga organizata të ndryshme çminuese gjatë gjithë këtyre viteve konsistojnë në çminues manual, makineri çminimi dhe qen mina kërkues. Qysh prej vitit 2004, DCA ka qenë i vetmi operator çminues në vend.

Që nga viti 1999 deri në fund të 2009, rreth 16,608,055 milionë metra katrorë tokë (duke përfshirë edhe zonat shtesë të ndotura të identifikuar gjatë survejimit) janë pastruar përmes operacioneve të survejimit dhe çminimit dhe më pas i janë dorëzuar banorëve në veri-lindje të Shqipërisë për



Çminim manual nga DCA

përdorim. Si rezultat, 12,452 mina kundër-personit, 152 mina anti-tank dhe 4,965 municione të paplasura janë gjetur dhe asgjësuar në këto zona.

Në vitin 2006, u krijua një kapacitet lokal çminimi me gjashtë skuadra çminuesish manual



Ceremoni e dorëzimit të tokës së pastruar

nën manaxhimin e kompanisë "DanChurchAid" përmes një projekti të financuar nga Komisioni Europian përmes PNUD Shqipëri. Qysh prej vitit 2007 DCA ka operuar me një kapacitet kombëtar dhe vetëm me një manaxher ndërkombëtar. Operacionet e çminimit gjatë gjithë këtyre viteve janë financuar nga Departamenti



Fëmijët gjatë një aktiviteti të MRE-së


Amerikan i Shtetit përmes ITF në Slloveni, Gjermania, Komisioni Europian, Danimarka, Republika Çeke, Mbretëria e Bashkuar dhe Kanada.

Edukimi i Popullsisë mbi Rrezikun Minave (MRE)

39 fshatra u prekën fillimisht nga ndotja me mina dhe municione të paplasura në verilindje të Shqipërisë në rrethet Kukës, Has dhe Tropojë. Të gjitha fshatrat e ndotura u mbuluan me edukim mbi rrezikun e minave. Një strategji e Edukimit mbi Rrezikun ndaj Minave u krijua qysh prej vitit 2002 me objektivat kryesore parandalimin e incidenteve nga minat/UXO në verilindje të Shqipërisë duke mbuluar të gjitha grupmoshat dhe duke futur gjithashtu në kurrikulen shkollore të lëndës për Edukimin mbi Rrezikun ndaj Minave. Si rezultat, numri i të aksidentuarve nga minat u reduktua nga 152 në vitin 1999 deri në aksidentin e fundit të regjistruar në Qershor të vitit 2005. Ulja e numrit të incidenteve/aksidenteve ka ardhur si rezultat i çminimit të zo-

nave të kontaminuara si dhe edukimit të popull-sisë mbi rrezikun nga minat në rajonin veri-lindor.

Aktivitetet e Edukimit mbi Rrezikun nga Minat përfshinë shpërndarjen e materialeve të Edukimit mbi Rrezikun nga Minat siç janë fletëpalosjet, posterat, performanca teatrale të lëvizshme



me anë të të cilave përçoheshin mesazhe sigurie përmes komedive dhe parodive, aktivitete nëpër shkolla, mbledhje periodike me komitetet anti-minë të ngritur në fshatrat e prekura nga ndotja, etj. Këto aktivitete u zhvilluan kryesisht nga Kryqi i Kuq Shqiptar dhe organizata ALB-AID (ish VMA-Kukës) si dhe u monitoruan dhe koordinuan nga Qendra Shqiptare e Veprimit ndaj Minave. Fondet përaktivitetet e edukimit mbi rrezikun ndaj minave janë siguruar kryesisht nga Departamenti Amerikan i Shtetit përmes ITF, UNICEF Shqipëri dhe ICRC.

Asistenca ndaj të aksidentuarve nga minat (VA)

Një strategji gjithëpërfshirëse për asistencën ndaj të aksidentuarve është adoptuar që në vitin 2003, me qëllim ndërtimin e një kapaciteti të qëndrueshëm shqiptar për dhënien e asistencës mjekësore, rehabilitimin dhe reintegrimin social-ekonomik të aksidentuarve. Objektivat kryesorë janë:

- Pajisja me proteza të gjymtyrëve të poshtme dhe trajtimi i të sëmurëve me dëmtime në shikim në Shqipëri ndërsa ato me dëmtime të gjymtyrëve

të sipërme dhe rasteve të vështira jashtë shtetit.

- Ndërtimi i një kapaciteti në verilindje të Shqipërisë për vendosjen e të gjitha llojeve të protezave deri në vitin 2010.
- Informimi i të aksidentuarve nga minat dhe komuniteteve mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.
- Reintegrimit ekonomik i të aksidentuarve nga minat përmes trajnimeve profesionale dhe skemave të mikro-financimeve për ngritjen e ekonomive me bazë shtëpiake.
- Ndërtimi i kapaciteteve në veri-lindje të Shqipërisë për trajtimin kirurgjikal të traumave dhe të aksidentuarve nga minat si dhe për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve mjekësore, sociale dhe rehabilituese për të aksidentuarit.

Disa nisma janë marrë për të arritur këto objektiva të cilat përfshijnë:

- Qendra e Protezave e ngritur pranë Spitalit të Kukësit që në mars të vitit 2005 po mbështetet me materiale lëndë e parë dhe pajisje të tjera dhe qysh prej vitit 2007 ka filluar prodhimin e protezave për gjymtyrët e poshtme.
- Ka filluar në maj të vitit 2006 projekti i mjekësisë fizike dhe rehabilituese (PMR – faza e I-rë & II-te) me mbështetjen e Handicap International, i financuar nga Departamenti Amerikan i Shtetit për të krijuar një kapacitet kombëtar për t'iu përgjigjur nevojave të aksidentuarve nga minat si dhe të personave të tjerë në nevojë.



Qendra e Protezimit në Spitalin Rajonal të Kukësit

- ICRC mbështet Qendrën Kombëtare të Orto-Protezave (NPOC) në Tiranë me lëndë të parë dhe vizita monitoruese. Tekniku i trajnuar për një periudhë 3-vjeçare në nivelin II të ISPO, është rikthyer në NPOC duke kontribuar në përmirësimin e kapaciteteve të qendrës.
- Me fonde të Komisionit Europian janë siguruar për Qendrën Kombëtare të Orto Protezave pajisje dhe lëndë e parë, një pjesë e të cilave



Darka e Njëmijë Gostive

janë dërguar në Qendrën e Protezave në Kukës.

- Një komplet pajisjesh fizioterapie i janë dhuruar Spitalit të Kukësit me fondet e Qeverisë Franceze dhe Komitetit Europian si dhe pajisje kirurgjikale iu dhuruan Spitalit të Tropojës të financuar nga K.E nëpërmjet PNUD.
- ITF siguroi në vitin 2004 dhe me pas në shtator 2009, pajisje mjekësore për Spitalin e Kukësit të financuara nga Departamenti Amerikan i Shtetit duke kontribuar në përmirësimin e kapaciteteve për shërbimin e emergjencës dhe shërbimin mjekësor në Spitalin e Kukësit.
- Një rrjet rehabilitimi me bazë tek komuniteti (CBR) është ngritur në veri-lindje të Shqipërisë në vitin 2005. Ky rrjet përbëhet nga 30 infermiere që punojnë në zonat e minuara dhe 2 mjekë specialistë (neurolog dhe fizioterapist) nga spitali i Kukësit. Pajisje mjekësore iu shpërndanë këtyre infermierëve në Kukës, Has dhe Tropojë ndërsa 2 fizioterapistë dhe 6 infermiere kanë kryer trajnime jashtë shtetit me financime nga Franca.
- 130 të amputuar nga minat të cilësuar si raste të vështira kanë marrë rehabilitim fizik dhe janë pajisur me proteza në Slloveni që nga viti 2001.
- 84 të aksidentuar nga minat dhe familjet e tyre u asistuan për të ngritur ekonomitë me bazë shtëpiake në mbajtjen e bagëtive me anë të një fondi qarkullues.
- 95 të dëmtuar nga minat/UXO ose familjarë të tyre nga Kukësi, Hasi dhe Tropoja, kanë përfunduar trajnime profesionale, sipas projekteve të financuara nga Komisioni Europian dhe SIDA nëpërmjet PNUD-it dhe me fonde nga Departamenti Amerikan i Shtetit nëpërmjet ITF-së.
- Nga aktiviteti humanitar, "Darka e 1000 Gostive" organizuar nga Ambasada Amerikane në tetor të vitit 2007 janë mbledhur rreth 19,000USD nga individë donatorë, përfshirë këtu sektorin privat, fonde të cilat u përdorën për të asistuar në aktivitetet mësimore 10 fëmijë të aksidentuar nga minat/municipionet e paplasura.

kontakte:

Arben Braha

Drejtor, Qendra Shqiptare e Veprimit ndaj Minave (AMAE)
E-Mail: amaealbania@amae.org.al
Tel / Fax: +355 4 2269 280; Mob. +355 69 20 94 629
Rr. "Donika Kastrioti" Pallati nr. 14, Ap 3A
Tirana – Albania
website: www.amae.org.al

Arian Starova

Zëvendës Ministër i Mbrojtjes
Kryetar i Komitetit Shqiptar të Veprimit ndaj Minave (AMAC)
E-mail: asta@mod.gov.al
Tel: +355 4 240084 Fax: +355 4 225 227